



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

21.05.2014, Prishtinë

THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIM

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me qëllim të avancimit të qeverisjes lokale i fton të gjitha organizatat joqeveritare që veprojnë në Republikën e Kosovës, të aplikojnë për realizimin e projektit “Avancimi i qeverisjes lokal” faza e dytë. Tashmë komunat e Republikës së Kosovës e kanë një bazë të qëndrueshme të infrastrukturës ligjore, përmes të cilës OJQ-të mund të japin kontributin e tyre në avancimin e mëtutjeshëm të modaliteteve qeverisëse, në të mirë të përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve. MAPL-ja vlerëson se përmes ndarjes së granteve u mundëson personelit të komunave të jenë sa më afër ideve novatore të organizatave joqeveritare, të cilat, gjithnjë në harmoni me legjislacionin gjegjës, sugjerojnë dhe praktikojnë ide më pragmatike në të mirë të avancimit të qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Kërkesat (Projekt-propozimet) duhet të përmbajnë:

1. Projekt-propozimin;
2. Buxhetin e detalizuar, si dhe arsyetimin e linjave buxhetore;
3. Afatin (dinamik) kohor për implementim;
4. Përshkrimin e detalizuar të kapaciteteve menaxhuese të organizatës (*personeli, pajisjet dhe aftësitë për të menaxhuar buxhetin e paraparë për aktivitete, etj*);
5. Një kopje që dokumenton regjistrimin e OJQ-së/ve, konform ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës;
7. Referencat për punë të ngjashme;
8. Aplikantët duhet të kenë xhirollogari në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

Të gjithë të interesuarit për aplikim mund të marrin informata në Departamentin për Transparencë dhe Përformancë Komunale në MAPL, përmes tel: 038 200 35 509 , ose në uebfaqen e MAPL-së: <http://ëëë.mapl-ks.org>

Propozimet e kompletuara e të mbyllura në zarf duhet të dorëzohen në Departamentin për Transparencë dhe Përformancë Komunale në MAPL, ish-“Rilindja”, kati X. Data e fundit për aplikim është 10 ditë nga data e publikimit.